




Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

Drejtoria e Arsimit dhe Kulture
04.Nr. 610/01-2019/20
Kaçanik

I N F O R M A T Ë

Për përfundimin e Periudhës së Parë të Vitit shkollor 2019-2020

Kaçanik, Janar 2020

Përmbajtja:

1. Hyrje
2. Investimet në infrastrukturën shkollore dhe pajisje tjera
3. Ngritja e cilësisë – zbatimi i Kurrikulës së re
4. Nivelet e arsimit - Edukimi dhe arsimi parafillor dhe fillor (0 dhe I-V)
 - 4.1. Rrjeti shkollor
 - 4.2. Suksesi i nxënësve – Arsimi fillor
5. Arsimi i Mesëm i Ulët (AMU, VI-IX)
 - 5.1. Nxënësit dhe suksesi i tyre në dy nivelet 1 dhe 2
6. Kuadri arsimor
7. Edukimi dhe Arsimi i Mesëm i Lartë (AML X – XII)
 - 7.1. Numri i nxënësve
 - 7.2. Suksesi i nxënësve
8. Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e pambytura të mësimdhënësve
9. Garat shkollore

Shkurtesat:

- DAK - Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës
- MASHT - Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
- PF - Parafillor ose niveli 0

- AF- Arsimi Fillor ose niveli 1 (klasa I-V)
- AMU- Arsimi i Mesëm i Ulët ose niveli 2 (klasa VI-IX)
- AML- Arsimi i Mesëm i Lartë ose niveli 3 (klasa X-XII)
- AJF- Arsimi Joformal

1. Hyrje

Informata për përfundimin e Periudhës së Parë ka për qëllim të njoftoj Institucionet komunale dhe publikun e gjërë mbi gjendjen e përgjithshme në fushën e arsimit të Komunës sonë për vitin shkollor 2019/2020. Informata përmban punën dhe aktivitetet e Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, respektivisht aktivitetet përgatitore për fillimin e vitit shkollor, furnizimin e shkollave me materiale pedagogjike, furnizimin e nxënësve me tekste shkollore, regjistrimin e nxënësve në klasat e para dhe klasë të dhjeta, numrin e fëmijëve parafillor, fillor, të mesëm të ulët dhe mesëm të lartë, zbatimin e Kurrikulës së re dhe suksesi i arritur gjatë kësaj periudhe mësimore.

Përmes këtij dokumenti, në formë tabelare janë prezantuar pasqyrat të cilat ofrojnë të dhëna për numrin e nxënësve sipas shkollave e sipas klasave, suksesi i arritur e të dhëna tjera të përgjithshme. Të dhënat e prezantuara mundësojnë analizimin e gjendjes së përgjithshme në sistemin e arsimit publik që zhvillohet në Komunën e Kaçanikut, në përputhje me Ligjin Nr.03/L-068 për Arsimin në Komuna të Republikës së Kosovës, e që zhvillohet në katër nivele: në nivelin 0, 1, 2, dhe 3 (Parafillor, Fillor, të Mesëm të Ulët dhe të Mesëm të Lartë). Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës (DAK) edhe sivjet ka filluar me kohë përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2019/20.

Fillimisht është bërë planifikimi i regjistrimit të fëmijëve parafillor e atyre në klasat e para. Bazuar në raportet e 12 shkollave filllore amë, këtë vit shkollor janë regjistruar gjithsej 472 fëmijë parafillor prej tyre 449 në Shkollat filllore e të mesme të ulëta të shpërndarë në 40 grupe e 23 fëmijë të tjerë të sistemuar në QEAP "Agimi", ndërsa janë regjistruar gjithsej 481 fëmijë në klasat e para. Po ashtu, është bërë edhe planifikimi i regjistrimit të nxënësve në klasat e X-ta, në 2 shkollat e mesme: në Gjimnazin "Skënderbeu" dhe SHMP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka". Në Gjimnazin "Skënderbeu" sivjet janë regjistruar 224 nxënës, ndërsa ishin planifikuar të regjistrohen gjithsej 256 nxënës të ndarë në 8 paralele (4 në drejtimin Shkenca Natyrore me 128 nxënës dhe 4 në drejtimin Shkenca Shogërore-Gjuhësore, po ashtu me 128 nxënës), e ndërsa në SHMP "Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka" janë regjistruar gjithsej 153 nxënës në 10 paralele, ndërsa kanë qenë të planifikuar të regjistrohen gjithsej 344 nxënës me 12 paralele të ndarë në 3 Drejtimet: 1. Elektroteknikë me profilet: Teknik i Telekomunikacionit, Teknik i Informatikës dhe Instalues Elektrikë me nga 1 paralele, 2. Ekonomi me profilet: Asistent i Marketingut, Kontabilitet dhe Tregti me shumicë dhe Pakicë me nga 1 paralele dhe 3. Makineri me profilet: Instalues i ngrohjes qendrore, Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit, Automekanik dhe Operator prodhimi, po ashtu, me nga 1 paralele. Numri i vogël i nxënësve të regjistruar në

klasat e dñjeta ka ndikuar që të mos themelohen 2 paralele të planifikuara: një në drejtimin ekonomik (Shpedicion dhe Logjistikë) dhe paralelja Saldator e drejtimit Makineri.

Sa i përket kuadrit arsimor, DAK gjithashtu me kohë e ka publikuar konkursin për plotësimin e vendeve të lira, ndërkohë që janë zhvilluar të gjitha procedurat e rekrutimit dhe selektimit, e për disa nga pozitat edhe është përsëritur konkursi.

Janë bërë përpjekje edhe për përgatitjet higjienike e teknike dhe kryesisht të gjitha shkollat kanë qenë të përgatitura në këtë aspekt për fillimin e vitit të ri shkollor 2019-2020.

2. Investimet në infrastrukturën shkollore

Para fillimit të vitit shkollor janë kryer shumë renovime të objekteve shkollore, ndërkaq gjatë periudhës së parë janë përruruar 2 objekte të reja shkollore: në Gllloboçicë dhe Ivajë dhe objekti i ri i QEAP-së “Agimi” në Kaçanik. Ndërtimi i objektit në Gllloboçicë është financuar nga MASHT e në Ivajë nga buxheti i Komunës, ndërsa objekti i QEAP-së nga fondet e BE-së. Punët kanë përfunduar edhe në objektin e ri në shkollën e Kovaçecit, financuar nga buxheti i komunës. Mësimi në këtë objekt nuk po mbahet në mungesë të inventarit të cilin duhet ta sjellë MASHT-i. Në shkollën e Kaçanikut të Vjetër, punët janë në fazën finale (objekti është duke u financuar nga MASHT), ndërsa është vu gurthemeli i objektit të ri për ndërtimin e shkollës së re në Doganaj. Në SHMP “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka” ka filluar realizimi i ndërtimit të fazës së dytë i cili është projekt trevjeçar dhe investohet nga MASHT. Në gjimnazin “Skenderbeu” ka filluar rregullimi i fushës sportive dhe meremetimi i hapsirave përcjellëse të sallës së edukatës fizike.

Projekte të financuara nga Buxheti komunal në vlerën e përgjithshme prej 68,882 euro

Renovime janë bërë në: SHFMU “Emin Duraku” në Kaçanik, në objektin e lagjes Dushkaja është bërë sanimi i defekteve të ujit, sanimi i nryeve sanitare dhe janë meremetuar muret e dëmtuara të cilat janë riparuar dhe ngjyrosur, ndërkaq janë investuar afër 12,000 euro e në objektin e shkollës së Runjevës, paralele e ndarë e SHFMU “Emin Duraku” është instaluar ngrohja me avull ku është instaluar kalldaja e ujit dhe radiatorët, në vlerë mbi 6 mijë euro. Në objektin e SHFMU “Kadri Zeka” në Dubravë është meremetuar kulmi i shkollës pastaj sanimi dhe izolimi i pllakave të dëmtuara dhe rregullimi dhe ngjyroja e plafonit me polikolor në shumë prej 9 mijë euro.

Në infrastrukturën shkollore është investuar edhe në shkollën e Bajnicës, paralele e ndarë e SHFMU “Nazmi Osmani” dhe në shkollën e Begracës. Në shkollën e Bajnicës është ndërtuar rrethoja përgjatë objektit dhe në fushën sportive janë ndërtuar shkallët nga betoni për shikues, ndërkaq janë shpenzuar afër 12 mijë euro, ndërsa në SHFMU “7 Shtatori” në Begracë është sanuar sistemi i trymës elektrike, ndërkaq janë investuar mbi 3 mijë euro.

Vlenë të theksohet se e gjithë shumta e investuar për këtë fillim viti shkollor është 68,882 euro, mjete të shpenzuara nga buxheti i Komunës.

Investime të tjera janë bërë edhe për pajisjen e qerdes së fëmijëve me pajisje e mjete të nevojshme si kuzhina me inventar dhe enë kuzhine e pajisje tjera të nevojshme si tepihë, perde e gjësende të ndryshme. Në ndërkohë edhe në shkollën e Bajnicës, paralele e ndarë e SHF MU “Nazmi Osmani” është realizuar projekti i efijencës së energjisë ku është bërë instalimi i ngrohjes me avull, izolimi termik, ndërimi i dritareve, renovimi i kulmit etj. Ndërkaq, në 3 shkolla të tjera (SHF MU “Jusuf Gërvalla”, SHF MU “Idriz Seferi” dhe SHF MU “Qamil Ilazi”) janë instaluar kamerat e sigurisë, ndërsa në 2 shkollat: në SHF MU “ Emin Duraku” në Kaçanik dhe “7 Shtatori” në Begraçë është investuar në kabinetet e Kimisë ku janë pajisur me tërë inventarin e nevojshëm dhe mbetet furnizimi me pajisje laboratorike.

3. Ngritja e cilësisë - zbatimi i Kurrikulës së re

Pjesë e përgatitjeve për vitin e ri shkollor kanë qenë edhe trajnimet e mësimitdhënësve për zbatimin e Kornizës Kurrikulare të Kosovës. Para fillimit të vitit shkollor, për 6 ditë me radhë janë trajnuar gjithsej 53 mësimitdhënës në 6 fusha kurrikulare (Matematika, Shkenca të natyrës, Shogëria dhe mjedisi, Gjuhë dhe Komunikim, Edukimi fizik, sporti dhe shëndeti dhe Mësimi Klasor, ndërkohë gjatë Shtatorit janë trajnuar edhe 14 të tjerë. Trajnimi është zhvilluar sipas planifikimit dhe agjendës së MASHT-it në bashkëpunim me DAK-në.

Edhe gjatë këtij viti shkollor, DKA ka bërë përpjekje për furnizimin me kohë të shkollave me materiale pedagogjike, ndërsa shkollat janë pajisur me kohë me materialet e nevojshme, ndërkaq që me kohë janë shpërndarë edhe librat për nxënësit të cilat edhe për këtë vit shkollor, qeveria e vendit, përmes MASHT-it dhe shtëpive botuese të kontraktuara, i kanë furnizuar falas nxënësit e nivelit Parashkollor dhe niveleve, I-V dhe VI-VII.

DAK, si organ menaxhues për çështje të edukimit dhe arsimit fuqimisht mbështet përkujdesjen për ngritje të cilësisë në procesin mësimor, duke implementuar reformat në mësimitdhënie dhe mësimnxënie, me theks të veçant zbatimin e Kurrikulës së re (Kurrikulës Bërthamë për Arsimin Parauniversita) dhe ofrimin e mundësisë që nxënësit e Komunës sonë të përfitojnë njohuri dhe kompetenca për të qenë konkurrent me bashkëmoshatarët e tyre në vend e më gjërë.

Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, duke qenë kompetente për zhvillimin e arsimit synon të ndërtojë një shogëri të arsimuar e të dijës, një sistem arsimor cilësor i krahasueshëm me arsimin e vendeve të zhvilluara. Ngritja e cilësisë mbetet prioriteti bashkë me ngritjen e kapaciteteve të mësimitdhënësve por edhe ngritjen e përpjekjeve dhe përgjegjësisë në punë.

Tani më janë trajnuar 190 mësimitdhënës në vitin 2017, 239 në vitin 2018 dhe 67 gjatë vitit 2019 të cilët kanë vijuar trajnimet për zbatimin e Kornizës Kurrikulare në Kosovë dhe të njejtë janë në zbatim të këtij programi të ri shkollor.

Përmes zbatimit të Kornizës Kurrikulare të Kosovës synojmë të arrijmë:

- Gjithëpërfshirjen - përfshirja e të gjithë fëmijëve në arsimin parashkollor dhe fillor; e drejta e secilit fëmijë dhe të ri për qasje dhe përfshirje të barabartë në arsimin cilësor, respektivisht ofrimi i mundësive që secili fëmijë të shpallot vlerat individuale dhe nevojat e tyre të veçanta e njëkohësisht të ndjehet i pranuar dhe i vlerësuar
- Zbatimin e kompetencave
- Mësimdhënien dhe nxënien e integruar dhe koherente
- Autonomia dhe fleksibilitet në nivel shkolle
- Përgjegjësinë dhe llogaridhënien
- Zbatimin e plan-programit mësimor;
- Vlerësimin e njohurive të nxënësve sipas standardeve,
- Sigurimin e mjedisit të pastër dhe favorshëm në shkollë dhe
- Funksionimin e aktiveve profesionale; sigurimin e mundësive për të përmirësuar cilësinë dhe tejkalimin e vështirësive.

4. Nivelet e arsimit - Edukimi dhe arsimi parafillor dhe fillor (0 dhe I-V)

Duke u bazuar në plan – programin për arsim parafillor dhe fillor, planin dinamik të punës, obligimet dhe përgjegjësitë e sektorit të arsimit në organizimin dhe mbarevajtjen e procesit edukativo-arsimor në Komunën e Kaçanikut, janë bërë të gjitha përpjekjet në bashkëpunim me shkollat dhe komunitetin për gjithëpërfshirjen e fëmijëve në arsimin parafillor dhe fillor dhe eliminimin e dobësive me qëllim të ngritjes së cilësisë në mësimdhënien dhe mësimnxënien.

Rëndësi e veçantë i është kushtuar zhvillimit dhe thellimit të dijeve, kultivimit të identitetit personal, zhvillimit të përgjegjësisë, aftësimi për jetë e punë e kompetenca tjera me qëllim që fëmijët të krijojnë kushte për zhvillim të pavarur personal dhe të kontribuojnë në ndërtimin e mirëqenies së shoqërisë në përgjithësi.

Arsimit parashkollor (nivelet 0) për fëmijët e moshës pesë vjeç, edhe deri më sot, është trajtuar në mënyrë meritore duke iu kushtuar vëmendje e veçantë. Në të gjitha shkollat kanë funksionojnë paralelet parafillore, me përfundim të asaj në Kollinë. Në vitin e kaluar 2018-19 pati filluar edhe në këtë shkollë paralela parafillore por ne ndërkohë në mungesë të fëmijëve, pushoi së funksionuari.

Në nivelin 0 (parafillor) sivejt janë regjistruar gjithsej 472 fëmijë të shpërndarë në gjithsej 40 grupe në shkollat fillore e të mesme të ulëta dhe 23 fëmijë të tjerë të përfshirë në QEAP “Agimi”, ndërkaj që sivejt në grupin e fëmijëve parafillor nuk është paraqit asnjë në shkollën e Kollinës. Nëse e krahasojmë numrin e fëmijëve të regjistruar sivejt me ata të vitit të kaluar (488 fëmijë), atëherë del se sivejt në këtë nivel janë përfshirë 16 fëmijë më pak se vitin e kaluar. Vlen të theksohet se edhe sivejt është duke u zbatuar Udhëzimi Administrativ 19/2016 për përfshirjen e fëmijëve në institucionet parafillore, që do të thotë se fëmijët e një paralele janë ndarë në dy grupe (një edukatore punon me dy grupe).

Përmes organizimit të këtij niveli shkollor synohet zhvillimi shoqëror, intelektual e fizik i çdo fëmije, e po ashtu synohet ushtrimi i rregullave themelore të sjelljes e të higjienës, kultivimi i vlerave, si dhe përgatitja për arsimin fillor të çdo fëmiju.

Arsimi bazë përfshinë nivelet 1 dhe 2 apo arsimin fillor (1-5) dhe arsimin e mesëm të ulët (6-9). Përmes zhvillimit të arsimit bazë, Komuna e Kaçanikut synon zhvillimin shoqëror, intelektual e fizik, të çdo nxënësi, zotërimin e rregullave të sjelljes dhe kultivimin e vlerave, përkujdesjen për shëndetin, si dhe përgatitjen e mjaftueshme për vazhdimin e arsimit të mesëm të lartë.

Arsimi i mesëm i lartë në Komunë e Kaçanikut zhvillohet në 2 shkolla të mesme. Përmes këtij niveli të arsimit, ne synojmë zhvillimin e mëtejshëm të kompetencave të fituara nga arsimi bazë, konsolidimin e individualitetit të çdo nxënësi, thellimin në fusha të caktuara të dijes, përgatitjen për arsimin tretësor ose për tregun e punës. Politikat tona zhvillimore janë të orientuara në përfshirjen apo krijimin e mundësisë për çdo nxënësi që përfundon arsimin bazë të regjistrohesh në arsimin e mesëm të lartë. Po ashtu, jemi fokusuar në përfshirjen e numrit sa më të madh të nxënësve në drejtimet që ofron Shkolla e Mesme Profesionale “Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka” e po ashtu edhe në Gjimnazin “Skënderbeu”.

4.1 Rrjeti shkollor

Në Komunën e Kaçanikut funksionojnë 12 shkolla amë dhe 12 paralele të ndara fizike:

1. SHFEMU “Emin Duraku” në Kaçanik me paralelet e ndara në Dushkajë, Runjevë, Gjurgjedell dhe Kërblig,
2. SHFEMU “Idriz Seferi” në Bob me paralelet e ndara në Kovaçec e Gajre
3. SHFEMU “Jusuf Gërvalla” në Biçec me paralelet e ndarë në Nikaj
4. SHFEMU “Kadri Zekë” në Dubravë me paralelet e ndara në Vatë e Provoli
5. SHFEMU “Ali Asllani” në Doganaj
6. SHFEMU “Nazmi Osmani” në Elezaj me paralelet e ndarë në Bajnicë
7. SHFEMU “Qamil Ilaçi” me paralelet e ndarë në Fushë të Pajimit
8. SHFEMU “7 Shtatori” në Begracë
9. SHFEMU “Agim Bajrami në Stagovë
10. SHFEMU “Gafurr Luma” në Gllboçicë
11. SHFEMU “Dituria” në Ivajë me paralelet e ndarë në Shtrazë dhe
12. SHFEMU “Naim Frashëri” në Kollinë

Përveç shkollave filllore në Komunën tonë funksionojnë edhe 2 shkolla të mesme: Gjimnazi “Skënderbeu” dhe SHMP “Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka” në Kaçanik dhe një çerdhe për fëmijë, QEAP “Agimi” në Kaçanik.

Bazuar në kushtet dhe mundësitë mundë të konstatojmë se rritet i shkollave të nivelit AMU dhe AML është i kënaqshëm dhe ekzistojnë kushte relativisht të mira për zhvillimin normal të procesit mësimor. Në Komunën tonë gjatë Periudhës së Parë të këtij viti shkollor kanë funksionuar gjithsej 23 shkolla të nivelit fillor, të plota dhe jo të plota, ndërsa, procesi mësimor për klasat VI-IX zhvillohet në 12 shkolla amë dhe në 8 paralele të ndara fizike.

4.2 Suksesi i nxënësve, Arsimi Fillor (1 – 5)

Në nivelin fillor, nga gjithsej 2433 nxënës sa ishin regjistruar në fillim të Periudhës së Parë, kanë vijuar gjithsej 2424 prej tyre, ndërsa sukses pozitiv kanë regjistruar 2411 nxënës, apo shprehur në përqindje 99.5 %. Me sukses negativ kanë ngelur 13 nxënës e 9 të tjerë nuk kanë vijuar ose janë çregjistruar.

Nëse e krahasojmë numrin e nxënësve të regjistruar në fillim të vitit shkollor, gjithsej 2433, me 2524 sa ishin regjistruar një vit më parë (2018/19), atëherë del se në këtë vit shkollor, 2019-2020, në këtë nivel, janë regjistruar gjithsej 91 nxënës më pak, ndërsa nota mesatare e këtij niveli arsimor është 4.03.

Për më shumë të dhëna të nivelit I-V, shih Tabelën Nr. 1

Suksesi në Arsimin Fillor (I - V) në Periudhën e Parë të vitit shkollor 2019 - 2020

			SUKSESI POZITIV													SUKSESI NEGATIV							TE PANOTUAR					
Klasa	Gj. nxenes	V/lojnë	Shkëlq.	Sh. mire		Mire	Mjaft.		Gj. pozitiv	%	Me 1x1		Me 2x1		Me 3x1		Gj. negativ		Nuk vijon	Te gregjist	N mes							
I	471	215	470	215	300	155	96	30	54	21	19	9	470	215	100	0	0	0	0	0	1	0	4.26					
II	504	236	502	236	273	158	121	50	73	21	35	7	502	236	100	0	0	0	0	0	2	0	4.08					
III	486	272	484	271	205	128	113	56	122	49	42	10	479	273	99	0	0	5	0	5	0	2	1	3.84				
IV	501	228	501	228	229	124	128	62	104	28	32	11	493	225	98.4	6	3	1	0	1	0	0	0	3.97				
V	471	228	467	243	211	118	105	45	112	47	39	15	467	225	100	0	0	0	0	0	2	1	2	3.96				
I-V	2433	1179	2424	1176	1218	669	563	243	465	166	167	52	2411	1172	99.5	6	3	1	0	6	0	13	3	2	1	7	3	4.03

5. Arsimi i Mesëm i Ulët (VI-IX)

Numri i nxënësve në AMU në fillim të vitit shkollor 2019/2020 ishte 1969, prej tyre 985 femra, ndërsa nëse e krahasojmë me një vit më parë (gjatë vitit shkollor 2018-2019 ky numri i nxënësve ishte 1999), del se në këtë vit shkollor 2019/20, në këtë nivel janë gjithsej 30 nxënës më pak.

Nga numri i përgjithshëm prej 1969 nxënësve të nivelit AMU, kanë vijuar 1957 dhe janë vlerësuar me nota pozitive gjithsej 1469 nxënës apo shprehur në përqindje 75.29 %, ndërsa me nota negative kanë ngelur gjithsej 482 e 18 të tjerë nuk kanë vijuar apo janë çregjistruar. Nota mesatare e këtij niveli arsimor del të jetë 3.3.

Për më shumë të dhëna për nivelin VI-IX, shih Tabelën Nr. 2

Suksesi në Arsimin e Mesëm të Ulët (VI - IX) në Periudhën e Parë të vitit shkollor 2019 – 2020

Klasa	Gj. nxenes		Vijojnë		Shkelq.		Sh. mire		Mire		Miaft.		Gj. pozitiv		%	Me 1x1		Me 2x1		Me 3x1		Gj. negativ		Nuk vijojnë		Te gregjist		Nota mes
	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F		GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	
VI	499	247	495	246	186	124	128	77	81	27	13	3	408	232	82.4	23	7	20	4	43	3	87	14	1	0	3		3.85
VII	488	241	484	240	130	98	108	52	92	37	21	4	351	211	72.5	58	12	27	6	49	8	133	24	2	1	2		3.48
VIII	483	265	479	263	145	115	108	70	97	37	14	4	363	227	75.8	39	22	24	8	53	5	116	35	2	1	2		3.56
IX	499	232	492	231	126	86	111	57	89	35	19	8	345	186	70.1	48	20	27	8	71	17	147	45	3	0	4		3.42
VI-IX	1969	985	1951	980	587	423	455	256	359	136	67	19	1469	857	75.3	168	61	98	26	216	30	482	118	8	2	10		3.3

5.1 Numri i nxënësve dhe suksesi i tyre në të dy nivelet 1 dhe 2 (I-V dhe VI-IX)

Numri i përgjithshëm i nxënësve në këto dy nivele, të regjistruar në fillim të vitit shkollor 2019/20 ka qenë 4402 (2164 femra) prej të cilëve kanë vijuar gjithsej 4374, ndërsa me sukses pozitiv janë vlerësuar 3880 apo 88.71 %. Ndërkaj, me nota negative kanë mbetur 494 nxënës prej tyre 121 femra e 28 të tjerë nuk kanë vijuar apo janë gregjistuar. Nota mesatare e përgjithshme e dy niveleve është 3.81. Nëse e krahasojmë këtë numër të nxënësve të regjistruar në fillim të vitit shkollor 2019/20 (4402) me numrin e nxënësve të regjistruar një vit më parë (4523) del se gjatë këtij viti shkollor numri i nxënësve të regjistruar është më i vogël për 121 nxënës.

Për më shumë të dhëna për nivelin I-IX, shih Tabelën Nr. 3

Suksesi sipas klasave I – IX në nivelin fillor dhe mesëm të ulët

SUKSESI POZITIV												SUKSESI NEGATIV												TE PANOTUAR				
Rendimi	Gj. neres		Vijone		Shkelq.		Sh. nire		Mre		Marti		Gj. pozitiv		%	Me 1x1		Me 2x1		Me 3x1		Gj. negativ		Nuk vijone		Te cregjist		Nota mesatare
	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F		GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	
I	471	215	470	215	300	155	96	30	54	21	19	9	470	215	100	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	4.26
II	504	236	502	236	273	158	121	50	73	21	35	7	502	236	100	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2	0	4.08
III	486	272	484	271	205	128	113	56	122	49	42	10	479	273	98.96	0	0	0	0	5	0	5	0	0	0	2	1	3.84
IV	501	228	501	228	229	124	128	62	104	28	32	11	493	225	98.4	6	3	1	0	1	0	8	3	0	0	0	0	3.97
V	471	228	467	243	211	118	105	45	112	47	39	15	467	225	100	0	0	0	0	0	0	0	0	2	1	2	2	3.96
IV	2433	1179	2424	1176	1218	669	563	243	465	166	167	52	2411	1172	99.46	6	3	1	0	6	0	13	3	2	1	7	3	4.03
VI	499	247	495	246	186	124	128	77	81	27	13	3	408	232	82.42	23	7	20	4	43	3	87	14	1	0	3	1	3.85
VII	488	241	484	240	130	98	108	52	92	37	21	4	351	211	72.52	58	12	27	6	49	8	133	24	2	1	2	1	3.48
VIII	483	265	479	263	145	115	108	70	97	37	14	4	363	227	75.78	39	22	24	8	53	5	116	35	2	1	2	1	3.56
IX	499	232	492	231	126	86	111	57	89	35	19	8	345	186	70.12	48	20	27	8	71	17	147	45	3	0	4	1	3.42
VLIX	1969	985	1951	980	587	423	455	256	359	136	67	19	1469	857	75.29	168	61	98	26	216	30	482	118	8	2	10	3	3.3
LIX	4402	2164	4374	2156	1815	1092	1018	499	824	303	234	71	3880	2029	88.71	174	64	99	26	221	33	494	121	10	3	18	6	3.81

6. Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e pambajtura të arsimtarëve

Për t'u arritur sukses i dëshiruar, komponentë e rëndësishme është vijueshmëria e rregullt e arsimtarëve dhe nxënësve në mësim. Ndryshe, mosvijimi i rregullt në orët e mësimi ndikon nëgativisht në suksesin e nxënësve, ndërkohë që ky faktor merret edhe si pasqyrë e mosdisiplinës së duhur në shkollë.

Në dy nivelet arsimore (I – IX), në këtë gjysmëvjetor janë angazhuar gjithsej 356 arsimtarë (167 femra) prej tyre 141 në mësimin klasor dhe 215 në atë lëndor, ndërsa të kualifikuar rezultojnë të jenë 348 apo shprehur në përqindje 97.75 %. Nxënësit e këtyre dy niveleve, AF dhe AMU, përçjatatë kësaj periudhe, kanë bërë gjithsej 35877 mungesa prej tyre 27053 të arsyeshme, ose 8.15 orë për kokë nxënësi. Ndërkaq, mësimdhënësit çjatatë këtij gjysmëvjetori kanë humbur 1219 orë mësimore ose mesatarisht nga 3.42 orë për arsimtarë.

Për më shumë informata shih Tabelën Nr. 5

Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e pambajtura të mësimdhënëseve në shkollat fillore dhe mesme të ulëta

Nr.	Emri i shkolles	KUADRI ARSIMOR																m ungesat e nxënësve		mesat. orët e pa m bajtura të arsimtarëve arsimtarë	
		Mësimi i klasor				Mësimi iëndor				Dy ciklet				nx.	ARS.	nx.	për				
		Gj	F	Kv	%	Gj	F	Kv	%	GJ	F	Kv	%								
1	"Emin Duraku"	36	33	35	97.2	46	21	45	97.8	82	54	80	97.56	15333	10800	10.85		429	5.43		
2	"Idriz Seferi"	18	10	18	100	24	10	23	98	42	20	41	98	2609	2061	5.44		174	4.14		
3	"Kadri Zeka"	15	4	15	100	17	3	16	94.1	32	7	31	96.87	2999	2674	7.3		54	1.68		
4	"Jusuf Gërvalla"	12	9	12	100	17	4	17	100	29	13	29	100	2865	2217	9.74		48	1.65		
5	"Qamili Ilazi"	13	8	13	100	19	8	19	100	32	16	32	100	3313	2819	7.14		87	2.71		
6	"Nazmi Osmani"	11	8	11	100	16	7	16	100	27	15	27	100	1881	1590	5.82		55	2.03		
7	"Ali Asllani"	8	5	8	100	17	4	17	100	25	9	25	100	2735	2213	8.81		33	1.32		
8	"7 Shtatori"	7	3	7	100	17	11	16	94.1	24	14	22	91.67	1382	901	4.83		29	1.21		
9	"G.Luma"	5	3	5	100	8	2	8	100	13	5	13	100	544	384	6.41		53	4.07		
10	"A.B."	5	3	5	100	11	2	11	100	16	5	16	100	839	680	5.55		39	2.43		
11	"Dituria"	7	3	6	86	12	3	11	92	19	6	17	87.47	1062	545	9.83		120	6.31		
12	"Naim Frashëri"	4	0	4	100	11	3	11	100	15	3	15	100	315	169	11		98	6.53		
	Gjithsej	141	89	139	1183	215	78	210	1176	356	167	348	97.75	35877	27053	8.2		1219	3.42		

7. Edukimi dhe Arsimi i Mesëm i Lartë (X – XII)

Edukimit dhe arsimimit në nivelin e Arsimit të Mesëm të Lartë (AML) i është kushtuar rëndësi e veçantë dhe përkujdesje e merituar, nga se pikërisht në këtë nivel merren hapat për të vazhduar studimet superiore, e po ashtu, edhe për përgatitjen profesionale të gjeneratave për tregun e punës.

Edhe në këtë nivel arsimor, synim kryesor është zhvillimi, zgjerimi dhe thellimi i dijes e njehkshësish dhe kultivimi i identitetit personal, zhvillimi i përgjegjësiave, aftësimi për jetë e punë e kompetenca tjera me qëllim që nxënësit të përballojnë sfidat e jetës dhe të punës dhe integritet më të lehtë të tyre në shoqëri.

7.1 Numri i nxënësve

Në vitin shkollor 2019-2020 në dy shkollat e mesme janë regjistruar gjithsej 1257 (687 mashkuj dhe 570 femra) prej tyre 720 në Gjimnazin "Skënderbeu" dhe 537 në SHMP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka". Është me rëndësi të ceket se këtë vit shkollor në dy shkollat e mesme janë regjistruar 159 nxënës më pak, krahasuar me vitin shkollor 2018/2019 që ishin të regjistruar gjithsej 1416 nxënës në dy shkollat. Në kuadër të Gjimnazit "Skënderbeu" këtë vit mësimor kanë funksionuar 2 drejtime me po aq profile: Shkenca Natyrore dhe Shkenca Shoqërore-Gjuhësore, me nga 4 paralele, ndërsa në SHMP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka" kanë funksionuar 3 drejtime: 1. Elektroteknikë me profilet: Teknik i Telekomunikacionit, Teknik i Informatikës dhe Instalues Elektrik, 2. Ekonomi me profilet: Asistent marketingu, Kontabilitet dhe Tregti me pakicë dhe shumicë dhe drejtimi i tretë (3) Makineri me profilet: Instalues i Ngrohjes Qendrore, Instalues i Ujësjetësit dhe Kanalizimit, Automekanik dhe Operator prodhimidhi. Për dallim nga vitetet tjera, sivjet nuk është duke funksionuar drejtimi i Juridikut me profilin Asistent Juridik.

7.2 Suksesi i nxënësve

Nga numri i përgjithshëm prej 1257 nxënës (570 femra) të regjistruar në fillim të vitit, mësimin e kanë vijuar gjithsej 1212 nxënës, prej tyre 559 femra, ndërsa sukses pozitiv kanë treguar 617 ose 50.90 %. Me nota të pamjaftueshme kanë mbetur 595 nxënës ose 49.10 % prej tyre dhe të panotuar e të rregjistruar kanë mbetur gjithsej 45. Suksesi i arritur reflekton vlerësimin e njohurive të arritura të nxënësve për këtë Periudhë të Parë të vitit shkollor 2019-2020, ndërkaj nota mesatare e nxënësve për dy shkollat e mesme del 2.96 dhe atë në Gjimnazin "Skënderbeu" 3.59 dhe SHMP "Feriz Guri dhe Vellezrit Çaka" 2.34.

Për më shumë informata shih Tabelën Nr.6

Suksesi në shkollat e Mesme të Larta në Periudhën e Parë të vitit shkollor 2019/20

Emri i shkollës	klasa	Të regjistruar	Vijojnë	SUKSESI POZITIV										SUKSESI NEGATIV										TË PA NOTUAR																																		
				shkëlq.		sh.mirë		mirë		mjaf.		Gjith pozitiv		%	1X1				1X2				Përsërisht me 3x1		Gjithsej negativ		Nuk vijon		Te		nota mesatare																											
															Gj		F		Gj		F		Gj		F		Gj		F			Gj		F		Gj		F																				
"Skënderbeu"	X-XII	720	443	710	438	168	130	196	145	78	38	7	5	449	318	63.2	109	59	62	29	90	32	261	120	0	0	10	5	3.59																													
																														X	163	32	144	28	1	0	9	3	32	7	7	2	49	12	34.03	19	3	20	5	56	8	95	16	19	4	0	0	2.36
Sh.M.Profesionale	X-XII	537	127	502	121	10	3	29	16	109	28	20	4	168	51	33.47	82	18	69	14	183	38	334	70	35	6	0	0	2.34																													
																														X	190	47	182	45	4	0	5	2	37	9	5	0	51	11	28.02	29	4	20	4	82	26	131	34	8	2	0	2.29	
																																																										XI
Gjithsej		1257	570	1212	559	178	133	225	161	187	66	27	9	617	369	50.9	191	77	131	43	273	70	595	190	35	6	10	5	2.96																													

8. Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e pambajtura të mësimdhënësve në AML

Vijimi rregullt i nxënësve është faktor i rëndësishëm në procesin mësimor që ka synim nxënien e diturive të reja.

Në fund të kësaj periudhe nxënësit e nivelit të AML-së kanë bërë gjithsej 28884 mungesa (18144 nxënësit e Gjinnazit dhe 10740 ata të SHMP) prej të cilave me arsye 20793 ose 23.83 për kokë nxënësi. Numri i orëve të humbura nga nxënësit dhe arsimtarët është relativisht i lartë, ndërsa kërkohet nga shkollat përkatëse të ndërmartin masat e duhura me qëllim të zvogëlimit në minimum të numrit të orëve të humbura mësimore. Ndërkaq, arsimtarët e nivelit të AML-së kanë humbur gjithsej 613 orë mësimi apo 6.31 orë mësimi për një arsimtar.

Kualifikueshmëria dhe ngrija profesionalizmi është kusht elementar dhe kyq për realizimin e suksesshëm të plan-programit mësimor dhe njëkohësisht është faktor për mësimdhënien e mësimnxënien të suksesshme, andaj edhe këtë vit shkollor i është kushtuar vëmendje e veçantë. Kështu, në fillim të vitit shkollor në dy shkollat e këtij niveli janë angazhuar gjithsej 97 mësimdhënës (94 të kualifikuar ose 96.9 %) prej tyre 45 në Gjinnazin "Skënderbeu" me shkallë të kualifikueshmërisë 95.56 % dhe 52 në SHMP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka" prej të cilëve 51 të kualifikuar ose 98. %.

Për më shumë informata shih Tabelën Nr.7

Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e pambajtura të mësimdhënësve në shkollat e Mesme të Larta

Nr.	Emri i shkollës	KUADRI ARSIMOR					MUNGESAT E NXËNËSVE		Mesatarja për nxënës	Orët e humbura të arsimtarëve	Mesatarja për arsimtarë
		Gj	F	KV	%	Gj	ARSYESHME				
1	"Skënderbeu"	45	22	43	95.56	18144	12052		25.2	222	4.93
2	SHMP	52	15	51	98	10740	8741		20	391	7.51
Gjithsej		97	37	94	96.9	28884	20793		23.83	613	6.31

9. Garat shkollore

Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, me qëllim të nxitjes së nxënësve për thellimin e njohurive të tyre, për çdo vit organizon dhe mban garat shkollore të diturisë në disa lëndë mësimore. Garat e Fizikanëve të Rinj e organizuar nga Shogata Kosovare e Fizikës, si çdo vit do të organizohet edhe sivjet. Gara do të mbahet më 25 janar në Prishtinë në Departamentin e Fizikës të FSHMN-së.

Po ashtu, në nivel komunal organizohen edhe gara tjera me qëllim të zhvillimit të shkathësisë e promovimin e talentëve të rinj etj, ndërsa nxënësit e shkollave të Komunës sonë marrin pjesë edhe në garat që organizohen në nivel vendi. Ndërkohë, që gjatë periudhës së parë Shogata e Pedagogëve të Kulturës Fizike ka organizuar dhe mbajtur gara shkollore në disa lëmi sportive me nxënësit e nivelit fillor e mesëm të ulët dhe ata të nivelit të mesëm të lartë. Garat janë mbajtur në futboll, basketboll, volejbol, shah dhe pink pong. Ekipe dhe individët më të sukseshëm janë shpërblyer me mirënjohje e medalje të ndryshme me qëllim të nxitjes dhe promovimit të talentëve të rinj.

Drejtori i Drejtorisë

Zahir Doda

